

FUTURE UNIVERSITY OF TIRANA SHPK
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
01.01.2018 – 31.12.2018

Shoqëria **FUTURE UNIVERSITY OF TIRANA shpk** i ka ndërtuar Pasqyrat Finaciare për Vitin 2018 në bazë të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit dhe përkatësisht në mbështetje të plotë të SKK2.

Shoqëria është regjistruar në vitin 2009 për të dhënë shërbime në fushen e arsimit të lartë universitar dhe pasuniversitar jo publik duke ofruar:

- Përgatitje të specialistëve të lartë në fushën e shkencave juridike, ekonomike, inxhinierike, shkencave të aplikuara, etj.
- Oportunitete për të kryer studime, kërkime dhe botime në fushat e mësipërme
- Kurse të specializimit dhe kurse të kualifikimit afatshkurtër e afatgjatë në degë e specialitete.

Pasqyrat Finaciare janë përgatitur duke ndjekur e zbatuar:

Politikat Kryesore Kontabël:

Politika për njohjen e aktiveve, për njohjen e detyrimeve, njohjen e të drejtave, njohjen e të ardhurave e shpenzimeve dhe vlerësimin e tyre.



Parimet Kontabël:

Parimi i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, parimi i njësisë ekonomike raportuese, parimi i vijimësisë së veprimtarisë ekonomike si dhe parimi i kompensimit.

Karakteristikat cilësore të informacionit Kontabël:

Karakteristikat kryesore që janë mbajtur parasysh gjatë hartimit të Pasqyrave Finaciare të vitit 2018 janë:

- Kuptueshmëria,
- Rëndësia dhe Materialiteti,
- Besueshmëria,
- Parimi i Paraqitjes me Besnikëri,
- Parimi i Përparësisë së Përmbajtjes Ekonomike mbi Formën Ligjore,
- Paanshmëria,
- Parimi i maturisë,
- Parimi i Plotësisë, Qëndrueshmërisë dhe Krahasueshmërisë



BILANCI KONTABËL

Shënimi 1 - Mjete monetare

Nr	Likuiditete tek	ALL	EUR	USD	Kursi	ALL
1	BKT ALL	19,564				19,564
2	UNION BANKA ALL	461,645				461,645
3	BKT Euro		79		123.42	9,711
4	UNION BANK EURO		271,692		123.42	33,532,270
5	Banka USD			20,295	107.82	2,188,207

Shënimi 2 - Të drejta të arkëtueshme-Nga aktiviteti i shfrytëzimit

Zëri "Nga aktiviteti i shfrytëzimit" në vlerën 71,084,665 lekë i referohet vlerës të pa arkëtuar të studentëve që ndjekin studimet pranë Future University of Tirana deri në 31 Dhjetor 2018.

Shënimi 3 - Shpenzime të shtyra

Zëri "Shpenzime të shtyra" në vlerën 714,400 lekë i referohet kryesisht shpenzimeve të akreditimit të cilat do të amortizohen ndër vite.



Shënimi 4 -Aktive të tjera afatgjata materiale/jo materiale

Zëri "Impiante dhe Makineri" në vlerën 15,059,045 lekë i referohet aktiveve afatgjata që disponon subjekti të pasqyruara në pasqyrën financiare me vlerën e mbetur pas aplikimit të normave të amortizimit të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

DETYRIMET DHE KAPITALI

Shënimi 5 -Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

Zëri "Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit" në vlerën 17,556,169 lekë nënkupton detyrimin e subjektit ndaj furnitorëve të pa likuiduar deri në 31 dhjetor 2018.



Shënimi 6 –Të pagueshme ndaj punonjësve

Zëri “Të pagueshme ndaj punonjësve” në vlerën 5,252,587 lekë i referohet vlerës së pagave neto të llogaritura të pa paguara ndaj stafit administrativ si dhe të pedagogëve që ofrojnë shërbimin e mësimdhënies.

Shënimi 7 –Detyrime Tatimore

Ky zë në vlerën **840,842** lekë analizohet si më poshtë vijon:

- Detyrime ndaj Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë për Kontribute Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore muaji Dhjetor 2018.
- Detyrime ndaj Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë për Tatimin mbi të Ardhurat Personale muaji Dhjetor 2018.
- Detyrime ndaj Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë për Tatimin në Burim muaji Dhjetor 2018, që do të paguhet brenda datës 20 Janar 2018.

Shënimi 8 – Të ardhura të shtyra


Nën zërin “Të ardhura të shtyra” në vlerën 98,970,181 lekë janë përfshirë të ardhurat e shtyra nga kontratat e studentëve që do të njihen si të ardhura gjatë vitit 2018 si pasojë e mos përputhjes së kohëzgjatjes midis vitit fiskal ushtrimor dhe vitit akademik shkollor.

Shënimi 9 – Kapitali

Zëri “Kapitali” në vlerën **(21,581,335)** lekë analizohet si më poshtë vijon:

- Kapitali nënshkruar në vlerën prej **100’000** lekësh i paguar me themelimin e shoqërisë, i cili ka qëndruar në të njëjtën vlerë nga periudha kur subjekti është themeluar.
- Fitimi i Pashpërndarë në vlerën **(29,264,404)** lekë i cili përmban rezultatin negativ të periudhave paraardhëse.

Fitimi për vitin financiar 2018 në vlerën **7,583,069** lekë



PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas Parimit të Kontabilitetit të të Drejtave të Konstatuara. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogariten me besueshmëri. Shpenzimet njihen atëherë kur ato sigurohen prej të tretëve dhe në të njëjtin periudhë kontabël me të ardhurat e lidhura.

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve është ndërtuar sipas Natyrës.

Shënimi 10 - Të Ardhurat

Në zërin e Të ardhurave shuma prej **113,133,619** lekë përfshin:

- Të ardhurat e shpërndara nga kontratat e vitit akademik 2017 - 2018
- Të ardhurat e shpërndara nga kontratat e vitit akademik 2018 - 2019
- Të ardhura të tjera.

Shënimi 11 - Shpenzime

Në zërin e Shpenzimeve shuma prej **106,291,987** lekë janë shpenzime të realizuara gjatë vitit ushtrimor 2018.

Hartoi

Elida Kërçari

E.K.

Administrator

Arjan ÇUKAJ

Arjan Çukaj

